



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6492 Prot.

Roskovec, më 25.08 2026

VENDIM

NR 43 .DATË 25.08 .2026

***“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN KORRIK 2026”***

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 16.07.2026, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Korrik 2026.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 8460/1 Prot.

Roskovec, më 17.07.2026

Procesverbal Nr.7

-I mbajtur sot, datë 16.07.2026, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Qershor 2026.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Qershor 2026.
5. Për ndryshimin dhe emërtimin e rrugëve në Bashkinë Roskovec.
6. Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” të Bashkisë Roskovec.
7. Për miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.46 datë 16.06.2018 “Për qeradhënien e zyrtare përkatëse të Bashkisë Roskovec”.
8. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026.
9. Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe Buxhetit të vitit 2026”.
10. Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2027-2029.
11. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13⁰⁸

Këshilltarët prezent: A.Plaka, E.Çepele, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, Zh.Metushi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, A.Pelo, S.Bibo Qamili, F.Feleqi.

Këshilltarët që mungojnë: A.Lamaj, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, J.Begaj, P.Toro, A.Hoxha, V.Çepele.

Prezent nga bashkia: Nënkyetari M.Goga, Dr.Ekonomike O.Goga, Dr.Juridike V.Zeqo, P/Shërbimit Social E.Kola, P/Integritet Europian N.Pelivani.

Me plotësimin e kuoromit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 14 këshilltarë. Kryetari – të nderuar këshilltar faleminderit për prezencën tuaj sot në sallën e Këshillit.

Duke vërejtur se kuorumi i nevojshëm është i pranishëm në këtë sallë për zhvillimin e mbledhjes, sipas njoftimit që keni marr në datën 10.07.2026, kjo është mbledhja e muajit Korrik 2026 i Këshillit të Bashkisë Roskovec. Do doja tju bëja me dije se në rendin e ditës që është shpërndarë tek ju sipas njoftimit të datës 10.07.2026, nga Drejtoria Ekonomike na është kërkuar që të shqyrtojmë sot dhe një projekt-vendim shtesë, i cili ka të bëjë me shtesë fondesh të akorduar për Bashkinë Roskovec nga transfertat e pakushtëzuara sektoriale për funksionimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, si dhe fondin prej 577,668 lekë transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme nga Ministria e Financave për vitin 2026. Duke vërejtur faktin se kjo është një shtesë e akorduar dhe për tu bërë e lëvrueshme duhet trupëzuar në dokumantat financiar të Bashkisë Roskovec, kam gjykuar që ta paraqesë dhe këtë pikë shtesë në rendin e ditës. Besoj që me këtë projekt-vendim keni pasur pak kohë të njiheni, ne e kemi shpërndarë në vendet e gjithsecilit prej jush. Për procedurë në lidhje dhe me këtë shtesë që kemi, ka nevojë dikush ta marri fjalën? Përsa kohë për procedurë nuk kërkon asnjë fjalën, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë rendin e ditës së kësaj mbledhje duke shtuar projekt-vendimin “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026”.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës bashkë me projekt-vendimin shtesë si më sipër dhe miratohet unanimit me 14 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro miratohet rendi i ditës.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Qershor 2026.

Kryetari- ju ftoj të merrni një informacion të shkurtuar nga ana e Sekretares së Këshillit, në lidhje me projekt-vendimet e marra në këtë Këshill në mbledhjen e muajit Qershor. Sekretarja e Këshillit- të nderuar këshilltar, ju bëj me dije në lidhje me vendimet që ju keni miratuar në mbledhjen e fundit, ku ju keni miratuar në total 4 vendime, nga të cilat siç e keni parë dhe në informacion, vetëm njëra ishte akt normativ të cilën e kemi nisur në Prefekturë për verifikim ligjor, Vendimi Nr.33 “Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2026” i cili është miratuar nga Prefektura. Pastaj ju e dini procedurën për shpërndarjen e vendimeve për zbatim, faleminderit. Kryetari- faleminderit Arlinda.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari- duke pasur parasysh se ka qënë një material voluminoz, tek ju ka ardhur në mënyrë të shkruar me shkrim dore, kush është pro? Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimit me 14 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro të këshilltarëve të pranishëm miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Qershor 2026.

Kryetari- nuk kemi ndryshime në këtë projekt-vendim, jemi dakort me atë parim që kemi lënë në Këshill, për sa kohë skemi ndryshime? Këshilltarët shprehen po. Kryetari- ju ftoj të votoni të nderuar këshilltar projekt-vendimin “Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Qershor 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro të këshilltarëve të pranishëm miratohet ky projekt-vendim, faleminderit për votimin.

5. Për ndryshimin dhe emërtimin e rrugëve në Bashkinë Roskovec.

Kryetari- këtë projekt-vendim do ta referojë Nënkryetari z.Maksi. Nënkryetari Maksi- të nderuar pjesmarrës faleminderit për pjesmarrjen. Në emër të grupit të punës i cili punon për marrjen e gjithë kërkesave nga shoqata të ndryshme dhe kryesisht nga Komiteti i Veteranëve, edhe nga këshilltarët, i drejtohem Këshillit të Bashkisë në kuadër dhe të 24 Korrikut ditës së Roskovecit, me një projekt-vendim për emërtimin e 4 rrugëve. Janë kërkesa kryesisht të qytetarëve, njëkohësisht edhe të Komitetit të Veteranëve dhe të këshilltarëve. Në njësinë Roskovec rruga Qemal Kamber Çepele, kjo rrugë ndodhet në qytetin e Roskovecit, është pa emërtim..Leksi- emërtimin e ka rruga mulliri i Rifatit..Maksi- po është pa emërtim të mirfilltë. Njëkohësisht në Njësinë Administrative Strum rruga në Suk 1 të marr emrin Xhemil Rrapush Sakaj. Në Marinëz kemi parashikuar rrugën e Marinzës, që është nga rruga e vjetër e Marinzës, jo kjo që kalon këtej nga shëtitë, Hekuran Hasan Nurka dhe emërtimi i ri tjetër është në Vidhishtë Rushit Çaus Hoxha. Këto janë 4 propozimet për rrugët të cilat ne mendojmë që edhe në kuadër të festës së 24 Korrikut, të jenë pjesë përbërëse e festimeve të familjarëve dhe të gjithë komunitetit. Njëkohësisht po qe se duhet dhe për pikën tjetër që mos ta marr fjalën 2 herë..Sekretarja- ta kalojmë njëherë këtë për procedurë..Kryetari- pika tjetër do të jetë në sekuencë specifike z.Nënkryetar. Atëherë për këtë projekt-vendim ka dikush pyetje? Po, fjala është për z.Fredi. Fredi- duke marr shkas nga praktikat e kaluara me emërtimin e rrugëve, është vënë re se të gjithë familjarët kanë paguar lekë privatisht nga 80 mijë lekë të vjetra, edhe këto kështu do vazhdojnë, do paguajnë? Maksi- po..Fred- po nuk është e drejtë..Maksi- e drejta është se nuk ka fond të miratuar as nga qeveria..Fred- si nuk ka fond tani, është turp i zotit tani tu marrim lekë privatisht atyre..Maksi- po nuk u marrim lekë privatisht, i bëjnë..Fred- privatisht more i marrim lekët, janë paguar nga 80 mijë lekë..Maksi- po ore dakort, i bëjmë tabelën, 60 mijë lekë bëjnë tabelat dhe 20 mijë lekë të vjetra..Fred- për çka jemi ne këtu tani? Maksi- jemi për miratim rruge jo për fondet për këtë punë, nuk miratojmë fonde për këtë punë, po hakun e punës e merr punëtori ndërsa fondet për..Fred- po është turp ore, si do marrim ne lekët e tabelave pastaj..Maksi- bëhen privat tabelat nuk bëhen kështu, bëhen sipas standarteve privat dhe nuk i ka Bashkia..Fred- nuk është e ligjshme..Maksi- hajt miratoni një fond pastaj për ndryshimin e tabelave dhe jemi dakort..Fred- ore është turp, si mund ti thuash atij tani atij familjari do të çojmë emrin e gjyshit tënd, po ai që ska familjar fare? Maksi- ai që ska familjar..Fred- po lëre tani se është e paligjshme, nuk e kuptoj çka morali keni, çka turp..të jem unë gjyshit e të kërkoj emrin e të paguaj lekë? Mirato një fond se nuk është ndonjë fond kushedi këtu..Maksi- bëhet një projekt..Fred- absolutisht jam dakort, ta propozojmë një fond..Maksi- dakort, të vij radhën tjetër..Fred- jo jo radhën tjetër që sot, e lëmë pikën tjetër dhe të miratojmë një fond, është turp e kupton? Nën zë të gjithë qytetarët nuk e kanë pranuar disa..Maksi- po disa se disa e kanë me qejf..Fred- po mirë more se është turp, pse për çka jemi ne këtu tani, ti detyrojmë ne tani ti e doje emrin e gjyshit..Maksi- pjesa më e madhe thotë faleminderit..Fred- tjetër i ke futur në sherr, ti

paguaj unë po çu emrin e gjyshit tim, po pse ky është morali? Kryetari- faleminderit, dikush tjetër? Ka pyetje në lidhje me projekt-vendimin? Për diskutim e kërkon kush fjalën? Atëherë kërkesë për pyetje dhe diskutim nuk kam, ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për ndryshimin dhe emërtimin e rrugëve në Bashkinë Roskovec”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro. Kryetari- me të gjithë votat pro miratohet ky projekt-vendim.

6. Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” të Bashkisë Roskovec.

Kryetari- edhe këtë projekt-vendim do ta referojë para jush Nënkryetari z.Maksi Goga. Maksi- dhe kjo është në kuadër të festës së 24 Korrikut, kemi miratuar dy qytetarë nderi, mendojmë ti drejtohem Këshillit të Bashkisë dhe për një qytetar tjetër pas vdekjes, Shamet Latif Faria i datëlindjes 25-sa, për të cilin e keni të shkruajtur sbesoj se ka nevojë, nga Kurjani me origjinë, ka dhënë kontribut në luftën Nacionalçlirimtare se është i 25-sës, dhe në gjithë aktivitetin e tij pas çlirimit dhe deri sa ka vdekur. Për këtë figurë i jemi drejtuar dhe në bazë të legjislacionit në fuqi Komitetit të Pastërtisë së Figurave në Tiranë, kemi marr përgjigje pozitive që nuk ka qënë bashkëpunëtor i sigurimit shtetëror. Leksi- nga të gjithë qytetarët që kemi kaluar, ky më ngjan materiali më i plotë se kemi pasur raste thashë dhe herën e parë që i kemi votuar, është pyetur Komisioni i Pastërtisë atje dhe pastaj i kemi shqyrtuar më mbrapa, kurse kjo është në rregull..Maksi- kemi marr për të gjithë..Leksi- po si kemi pasur bashkangjitur me materialin asnjëherë..Maksi- ok dakort..Leksi- hera e parë që vjen..Kryetari- mirë faleminderit z.Leksi, ka dikush pyetje në lidhje me këtë projekt-vendim që jemi duke diskutuar? Për diskutim e kërkon dikush fjalën? Nuk ka. Kryetari- atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” të Bashkisë Roskovec”, pikërisht për z.Shamet Latif Faria. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 12 vota pro, 2 vota abstenim F.Feleqi, A.Pelo. Miratohet ky projekt-vendim.

7. Për miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.46 datë 16.06.2018 “Për qeradhënien e zyrave përkatëse të Bashkisë Roskovec”.

Kryetari- ky është një projekt-vendim të cilin në këtë Këshill ne e kemi diskutuar dhe në mbledhjen e herës së kaluar, ka riardhur në Këshill i pandryshuar. Kam një pyetje, projekt-vendimi që na keni risjellë në Këshill ka ndryshime nga ai i herës së kaluar apo është i pandryshuar? P/Integritet European Nertila- jo, është i pandryshuar. Kryetari- faleminderit. Atëherë po ju thoj të nderuar këshilltar që projekt-vendimi “Për miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.46 datë 16.06.2018 “Për qeradhënien e zyrave përkatëse të Bashkisë Roskovec” ka riardhur nga administrata i pandryshuar në Këshill. Nertila- pra projekt-vendimi lidhet me transferimin e hapsirave të organizatës lokale “Gruaja, Komuniteti, Mjedis” e cila aktualisht sipas vendimit të mëparshëm është në Qendrën Rinore, në një hapsirë 6m² dhe në kushtet e zgjerimit të aktiviteteve të organizatës dhe angazhimeve komunitare dhe përfshirjes dhe të grave artizane, është menduar që të bëhet një transferim për një ambient më të madh 33m² në ambientet e Pallatit të Kulturës. Kryetari- faleminderit, duke qënë se ky projekt-vendim është diskutuar një herë në këtë Këshill, e ndiej përgjegjësi që të pyes nëse dikush ka për të diskutuar brenda atij limitit minimal kohor të mundshëm, diçka ndryshe apo shtesë nga ato që kemi diskutuar herën e kaluar? Nuk kemi

diskutime, atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.46 datë 16.06.2018 “Për qeradhënien e zyrave përkatëse të Bashkisë Roskovec”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 12 vota pro, 2 vota kundër F.Feleqi, A.Pelo. Miratohet ky projekt-vendim.

8. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026.

Kryetari- znj.Orgesa do të lutesha duke qënë se ky është një projekt-vendim i diskutuar në këtë Këshill, do të lutesha të na tregosh nëse kemi ndryshime apo jo nga projekt-vendimi që keni paraqitur në mbledhjen e kaluar të Këshillit. Orgesa- të nderuar këshilltar ka disa ndryshime të vogla sa i përketë këtij projekt-vendimi. Është hequr pika 2 për të cilën flisnin për fondet e ardhura pas përfundimit të projektit të “rivitalizimi i qendrës komunitare Kurjan” dhe kjo është kaluar në një pikë shtesë, duke qënë se na erdhën shumë fonde nga projekte të huaja, të cilët i kishim përfunduar, u certifikuan dhe na kaloi i gjithë fondi dhe i kaluam si pikë më vete. Këtu kemi të bëjmë vetëm me ato fonde që i përkisnin dhe kanë qënë të miratuara në buxhetin e vitit 2026, vetëm shpërndarje ndërmjet zërave buxhetor. Kemi shtimin e një zëri tjetër, hartim projekti ujësjells i në fshatin Ngjeqar, e cila ka ardhur si pasojë e kërkesave të shumta të banorëve të këtij fshati, të Njësisë Administrative Kurjan. Problematika është gjithashtu objekt i komunikimit të mëparshëm me institucione përgjegjëse të sektorit ujësjellës-kanalizime, me qëllim gjetjen e një zgjidhje për furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve në fshatin Ngjeqar. Pavarsisht kërkesave të vazhdueshme dhe rëndësisë së problematikës, deri më sot nuk është realizuar një investim për ndërtimin e një sistemi të ujësjellësit dhe fshati vijon të mbetet pa furnizim me ujë të pijshëm. Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Roskovec i kanë nisur shkresë institucioneve përgjegjëse të sektorit ujësjellës-kanalizime me shkresën Nr.5204 protokoll, të datës 08.07.2026 për tu informuar nëse ata kanë të hartuar një projekt për ndërtimin e ujësjellësit në fshatin Ngjeqar, ose e kanë këtë në planet dhe në programet e tyre afatmesme. Gjithashtu me shkresën Nr.5202 protokoll e datës 08.07.2026, Bashkia Roskovec i ka kërkuar Shërbimit Gjeologjik Shqiptar informacion dhe vlerësim teknik lidhur me mundësinë e ekzistencës së burimeve ujore që mund të shfrytëzohen për furnizimin me ujë të pijshëm të kësaj zone, dhe hartimi i këtij projekti është parashikuar në vlerën 3 milion lekë. Këto janë vetëm ndryshimet që..Maksi- dhe një shtesë që nuk është në projektbuxhet, po përse i përketë radhës së parë që diskutuam gjerë e gjatë për problemin e ujësjellësit të Ngjeqarit, do të jenë dy pika tani që dhe me këshilltarët kemi diskutuar. Pika e parë do të jetë furnizimi me 1 ose 2 herë në javë me ujë atyre familjeve që janë të domosdoshme, duke filluar që nga dita e Hënë e në vazhdim, të paktën gjatë periudhës së verës, dhe e dyta rezervuari i Stanit nuk do të hapet për furnizimin me ujë për vaditje por do të ngelet për ujë jo të pijshëm por ujë për shërbimet komunitare, të dyja këto janë marr masat. Fredi- po si do të marri ujë komuniteti, nuk do merret më për vaditje? Maksi- po, për arsye se është kërkuar nga komuniteti dhe nga këshilltarët që të mos merret ujë për vaditje por të ngelet ujë rezervuari për shërbime komunitare, e thithin me pompë. Kryetari- mirë faleminderit, atëherë për projekt-vendimin për pyetje kush e kërkon fjalën? Fredi- këto që pakësohen, këto do hiqen? Orgesa- po, këto janë të gjitha kontrata që janë realizuar, është bërë prokurimi, është lidhur kontrata dhe këto diferenca vijnë nga prokurimet..Fredi- këto hiqen fare si investime? Orgesa- janë realizuar këto si investime, këto janë

vetëm diferencat që kanë ngelur nga lidhja e kontratave, pra e kishim një rrugë të parashikuar riveshje me shtresa asfaltike 20 milion, është lidhur kontrata, kjo 9 milionshi që është këtu është diferencë e mbetur pas lidhjes së kontratave..Leksi- pas tenderimit..Orgesa- pas tenderimit, pas lidhjes së kontratës ajo është..Kryetari- po pra, tenderimi ka qënë më i vogël..Orgesa- po, ka qënë më i vogël..Maksi- diferenca midis shumë s të lekëve dhe tenderimit që aplikohet..Kryetari- dikuh tjetër e kërkon fjalën për pyetje? Për diskutim në lidhje.. Fredi- për semaforët, e para e punës ne kemi rrethrotullim nuk kemi nevojë për semafor për moment, vlera është 100 milion lekë, më duket shumë e tepërt sepse e para nuk kemi nevojë, e dyta 100 milion lekë janë shumë lekë për komunitetin në këto momente. Fieri ka 2 semafor gjithë ai qytet dhe këtu nuk është e nevojshme sepse në qoftë se do çohet semafor do hiqet rrethrotullimi, kështu që më duket e tepërt, vetëm kjo është arsyeja vetëm në qoftë se i është dhënë llafi dikujt që ka prurë një kontinier me semafor dhe ti plotësojë dëshirën dikujt, po nuk është e nevojshme. Zhaku- ku do vendoset semafori? Maksi- tek ish zyrat e Bashkisë, përpara zyrave të Bashkisë, ska rrethrotullim atje të jemi korrekt me njëri-tjetrin..Fredi- ku? Maksi- tek lokali që të jemi korrekt, midis ish Bashkisë së vjetër, rrethrotullimi aty që është dy pika që janë pedonalja e qytetit dhe kërkohet për të kufizuar në pedonalen e qytetit qarkullimin, do bëhet semafori. Fredi- shiko mua më duket shumë e tepërt sepse me një të rënë të lapsit 100 milion lekë janë semafor, 42 milion e gjysëm janë bibliotekë dhe mos të bësh 2 çezma në fshatin Ngjeqar që ti kërkojnë të paktën dy këshilltar, unë të paktën kam 13 vjet që e kam kërkuar. Kjo është arrogancë, kjo është mospërfillje pavarisht projektit, unë jam dakort dhe për projektin me të dyja duart, e ça është kërkuar, e ça duhet por kjo është arrogancë. Sot ai fshat nuk ka ujë, janë 240 familje pavarisht se janë 350 taksapagues, 2 çezma edhe me një të rënë të lapsit 142 milion lekë, 5 punonjës 50 milion lekë, 200 milion lekë me një të rënë të lapsit, dhe në kopshtin Jagodinë të vendosen karriget nga familjarët, të merren karrige nga shtëpia të ngjitur me skoç, me vinovil dhe ajo edukatorja atje është për tu falenderuar, sinqerisht për tu falenderuar. Unë nuk e njihja hera e parë që e kam parë, mu betua dridhej sepse kishte frikë, kishte dhe emocion, kishte marr bojë, kishte marr gëlqere e kishte lyer vet, i kishin rënë duart, kishte marr dhe burrin, e kishte blerë vet bojën dhe gëlqeren dhe ai komunitet ishte shumë falenderues për atë zonjën atje. Dhe banjoja pribret të zotit dhe ne me një të rënë të lapsit këtu, gjera që për mua nuk duhen, janë luks nuk e di, e kupton janë të tepërta. Ne kemi një komunitet, kemi rrugës njerëz pa bukë, me sinqeritet jo se po bëj unë bamirsin, kalon në Kuman gjenë një plakë atje për lëmoshë 2 mijë lekë dhe unë propozojë një amient atje, ambienti 30m ose të marrim një lokal me qera ose të japim një kështu, të përdoren 20 pjata more ushqim në ditë, një vakt të paktën..Maksi- japim, nuk ke informacionin po marrin, familjet e vetmuara marrin ushqim..Fredi- jo mo jo një zë, unë nuk e di..Maksi- ua çojmë në shtëpi po të them edhe njëherë, familjet e vetmuara ua çojmë në shtëpi..Fredi- nuk e di, të marrin more 20, ka njerëz, unë nuk e di ku dhe kur..Maksi- ti jap une informacionet, 30 familje në ditë trajtohen me dreka ushqimore nga Bashkia..Fredi- nuk e kam ditur..Leksi- kemi kaluar dhe fond..Fredi- po mirë e kemi kaluar, ore mund të kemi kaluar shumë gjëra, më vjen keq ore Leksi kanë kaluar shumë gjëra..Leksi- në rregull por thashë është, që trajtohen..Fredi- dhe të kalojnë me një të rënë të lapsit 200 milion lekë, për mua është shumë e tepërt. Këto kisha, unë jam dakort të ndryshohen ato pikat, të hiqen ato semaforët, të hiqen ato për biblioteka, është turp i zotit, ça na duhet ne biblioteka, ska ujë atje 2 çezma nga 500 mijë lekë atje spo bëhen dhe duan të përdorin 200 milion lekë, njerëzit janë në hall ore..Kryetari- faleminderit z.Fredi, po Orgesa.. Orgesa- doja të shtoja një informacion përsa i përketë godinës së shkollës ose kopshtit që ndodhet në fshatin Jagodinë. Ne sapo kemi nisur jemi në fazën e prokurimit, po

vendosim kriteret nga njësia e prokurimit për rikonstruksionin komplet të godinës. Maksi- me lekët e Bankersit..Orgesa- edhe Bashkia Roskovec, është me bashkëfinancim..Kryetari- faleminderit, atëherë për këtë projekt-vendim për diskutim nuk e kërkon dikush fjalën? Ashtu sikundër dëgjuam dhe nga specialistja, drejtoresha në këtë rast e cila prezantoi këtë projekt-vendim, ju ftoj të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026” duke hequr nga projekt-vendimi i cili ju është shpërndarë ju pikërisht pikën 2, e cila ka kaluar në projekt-vendimin shtesë që kemi. Për të saktësuar pika 2 është : bazuar në kërkesën dhe relacionin e dërguar nga stafi i projektit me financim të huaj “Rivitalizimi i Qendrës Komunitare Kurjan”..Kjo pikë kalon bashkë me projekt-vendimin e fundit që kemi për të diskutuar në këtë mbledhje të Këshillit. Kjo pikë është hequr gjithashtu nga relacioni. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin me ndryshimet e sipërcituara dhe miratohet me 11 vota pro, 1 votë abstenim E.Toska, 2 vota kundër F.Feleqi, A.Pelo. Kryetari-me 11 vota pro, 1 abstenim dhe 2 kundër miratohet ky projekt-vendim. Faleminderit znj.Orgesa.

9. Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe Buxhetit të vitit 2026”.

Kryetari- atëherë z.Nënkryetar ju lutem duke iu referuar diskutimeve të herës së parë, të na thoni nëse ky projekt-vendim ka pësuar ndryshime nga forma që ka ardhur në mbledhjen e kaluar? Maksi- ky projekt-vendim nuk ka pësuar asnjë lloj ndryshimi, ka të bëjë me shtesën e fuqisë punëtore, me 5 fuqi punëtore, 1 përgjegjës dhe 4 elektropompista në stacionin e pompimit që do të vihet në punë për furnizimin me ujë të vaditjes të liqenit të Kurjanit. Janë dy stacione pompimi, një te Hoxhenjtë dhe një në Matkë, që do të furnizojnë me ujë liqenin e Kurjanit dhe kërkohet me çdo kusht meqenëse janë dy nënstacione pompimi të reja, të fuqishme dhe janë të kohës, kërkojnë me çdo kusht që në çdo vend të ketë nga 24 orësh të ketë nga një fuqi punëtore, kështu që nuk ka ndryshime nga relacioni i parë. Kryetari- faleminderit, fjalën për diskutime? Përtej çfarë kemi diskutuar, po fjala është për ju z.Fredi. Fredi- funksionon sot? Maksi- jo, është i ri..Fredinuk funksionon..Maksi- nuk është vënë në punë, tani do vihet në punë..Kryetari- dikush tjetër? Për diskutim e kërkon dikush fjalën? Ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin..Fredinuk e kisha pyetje unë atë..Kryetari- jo për diskutim pyeta po smora përgjigje..Fredinuk ajo është shtesë organike, është për të mbushur orekset, është për votat, është për të shpenzuar për të bërë rrush e kumbulla lekët e qytetarëve, taksat e qytetarëve. Ai funksionon, punonjësi ka sa asnjëherë tjetër..Maksi- e ke gabim tani, edhe një herë më bëre pyetje dhe unë të ktheva përgjigje, tani kam të drejtën e replikës kur thuhet ai funksionon. Janë dy stacione të reja, nuk funksionojnë..Kryetari- z.Maksi le ta mbarojë 2 minutëshin e replikës..Fredinuk stë ndërpreva, në qoftë se doni ti bëni rrush e kumbulla i bëni, votat i keni edhe këshilltarët i keni detyruar, i keni sforcuar, e kupton? Për teka, për huqe, për vota, po bëni lekët e taksave të qytetarëve rrush e kumbulla. Administratë më të fryrë ndonjëherë nuk ka pasur, pavarsisht bashkive të tjera por kjo për nivelin e bashkisë që ka, më të fryrë Bashki se kjo nuk ka. I shikojmë punonjësit po rrinë kot gjithë ditën, megjithatë bëjeni por është turp, njerzit janë në hall, fshatrat janë pa rrugë, fshatrat janë pa vaditje, fshatrat janë pa ujësjellës, fshatrat janë pa ujë, janë në hall. Ju jeni vet dëshmitar që skrepi është fikur për naftë, edhe të shtosh me një të rënë të lapsit 5 punonjës 50 milion lekë këtu mua më duket absurde, shto ujë e shto miell, ne jemi kundra. Kryetari- faleminderit z.Fredi. Maksi- tani ka mundësi? Kryetari- replikë të shkurtër..Maksi- dy

nënstacionet..bëtë pyetje po ju kthej përgjigje për herë të dytë, dy nënstacionet e pompimit nga Semani për në rezervuarin e Kënetës së Zezë dhe nga Kënetë e Zezë për në rezervuarin e Kurjanit janë stacione të rinj, është një risi për Roskovecin që ish stacionet e pompimit të kohës së monizmit po vihen në punë për herë të parë..Që të vihen në punë për herë të parë, të gjitha pajisjet janë të kohës elektronike dhe kërkojnë me çdo kusht që të ketë nga një fuqi punëtore në 24 orë, pra 4 fuqi punëtore dhe një përgjegjës për të dyja nënstacionet. Nuk është luks por është domosdoshmëri që ka qënë kërkesë e vazhdueshme e gjithë fermerëve të Bashkisë. Ai rezervuar do të furnizojë gjithë zonën e Roskovecit dhe të Kumanit, po të njëjtën gjë do të bëjë dhe për zonën e Strumit deri në Velmish, faleminderit. Kryetari- faleminderit, po fjala është për z.Elmaz për diskutim..Elmazi- unë isha i mendimit, kjo ka bërë mirë që e ka prurë atë organikë prej 5 vetash se kur ka ardhur problemi këtu në Këshill për fatkeqësinë që u ka ndodhur njerzve tanë, shokëve tanë, miqve tanë me këtë proces pune, kemi vënë duart në kokë dhe atje është e domosdoshme. Për atë që ka punuar në elektrik, për atë që e njeh elektrikun, për atë që ka bërë shkollën për elektrikun, për mua është mëse normale 5 punëtor. Se është shumë lekë, se duhet vënë në Ngjeqar se ska ujë, kjo është e drejta e qytetarit, e këshilltarit që e ngre dhe kjo është ngritur disa herë ky problem, por të thuash që mos të vihen elektropompat në punë..Fredri- nuk e thashë atë..Elmazi- të lutem..Fredri- po të lutem mos më thuaj, unë stë thashë mos të vihen, nuk e thashë atë..Kryetari- ju lutem të mbarojë këshilltari..Elmazi- që të kërkohet që ato pompa mos të shfrytëzohen sepse vihet fuqi punëtore për mua nuk është e drejtë, duhet të vihet. Se do të jetë rruga tjetër, duhet gjetur rrugë për të cilën ne dhe grupi ynë e ka ngritur, sidomos për fshatin Ngjeqar, sidomos fshati Ngjeqar e përsërisë disa herë për një pikë ujë, prandaj ajo është e domosdoshme dhe ata punëtorët, por i lutem atyre që i drejtojnë të vënë specialist në atë fushë, të mos vënë militant politik. Atje duhet specialist që kur të iki nga pika ti thotë shokut mbylle se po hipi në shtyllë, prandaj këtë ja them të gjithë këshilltarëve por i them dhe Nënkryetarit të Bashkisë që është këtu, mundësisht zgjidhni specialist, faleminderit. Kryetari- faleminderit z.Elmaz, dikush tjetër për diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim? Nuk kemi kërkesa, ju ftoj të nderuar këshilltar të votoni projekt-vendimin “Për miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe Buxhetit të vitit 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 12 vota pro, 2 vota kundër F.Feleqi, A.Pelo. Kryetari- me 12 vota pro, 2 kundër miratohet ky projekt-vendim.

10. Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2027-2029.

Kryetari- projekt-vendim ky i cili vjen për..e kishim dhe këtë në mbledhjen e kaluar? Sekretarja-po. Orgesa- e kishim dhe herën e kaluar..Kryetari- dhe do doja tju drejtoja të njëjtën pyetje që në qoftë se ka ndryshime nga projekt-vendimi i kaluar? Orgesa- jo nuk ka asnjë ndryshim, bëhet fjalë për të njëjtin projekt-vendim. Kryetari- atëherë nga këshilltarët kemi ndonjë pyetje shtesë nga ato që janë diskutuar në lidhje me këtë projekt-vendim në mbledhjen e Këshillit, në mbledhjen e kaluar të këtij Këshilli? E kërkon dikush fjalën? Për diskutim? Atëherë nuk kam asnjë kërkesë për pyetje apo për diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim, ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2027-2029”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 12 vota pro, 2 vota abstenim F.Feleqi, A.Pelo. Kryetari- me 12 vota pro, 2 vota abstenim miratohet ky projekt-vendim, faleminderit këshilltarëve.

11. Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026.

Kryetari- jemi me projekt-vendimin e fundit në rend të ditës për këtë mbledhje të Këshillit të Bashkisë Roskovec dhe është pikërisht projekt-vendimi që erdhi shtesë në këtë mbledhje të Këshillit që është ai “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026”, shkurtimisht..Orgesa- po, të nderuar këshilltar jam para jush për tju prezantuar projekt-vendimin “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026”. Në datën 30.06.2026 sipas aktit normative Nr.2 “Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit 87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, ne na ka ardhur për Bashkinë Roskovec një fond shtesë i akorduar prej 1276 lekë transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, vlerat janë në mijë lekë dhe fondi 577 mijë lekë transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme nga Ministria e Financave. Fondi për punonjësit e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi ka ardhur një shtesë për pagat dhe sigurimet për orët shtesë të tyre, kurse transfertat e përgjithshme 577 ishte me përcaktim të Bashkisë Roskovec. Gjithashtu pika e dytë të miratohet fondi shtesë i ardhur pasfinancimit dhe çertifikimit të projektit SusAgri, i cili ka nisur në vitin 2024 në Bashkinë e Roskovecit dhe ka përfunduar në fund të vitit 2025. Pas auditimit që kaluam nga Bashkimi Europian dhe njohjes së të gjithave shpenzimeve të realizuara nga Bashkia Roskovec, ne kemi arritur që ta përfitojmë mbrojtjen e të gjithë fondin për të cilin kemi aplikuar dhe kemi zbatuar projektin, vlera e këtij është 816 mijë lekë. Gjithashtu projekti i tretë të cilin Bashkia Roskovec ka qënë në zbatim prej 3 vitesh, nga viti 2023 deri në Nëntor të vitit 2025, ka qënë gjithashtu projekti “Rivitalizimi i Qendrës Komunitare Kurjan”. Pas gjithë kontrolleve që kemi pasur nga delegacioni Europian, ne kemi arritur që të fitojmë dhe të njihen të gjitha shpenzimet dhe Bashkisë Roskovec ti rikthehet i gjithë fondi me të cilin kishte aplikuar, kishte zhvilluar projektin. Vlera e fondit bëhet fjalë për 3 milion e 508 mijë. Sipas tabelës së mëposhtme dhe zërat për të cilat do bëhet kjo ndarje, Bashkia Roskovec ka menduar në vlerën 1 milion lekë të bëjë mbështetje për start-up-e të reja, të financoj biznese të reja, të cilat kanë ide të rinj dhe gra të cilat kanë ide inovative për të hapur biznes, do ti japi një suport nëpërmjet thirrjeve që do hapim, aktivitete dhe iniciativa mbi çështjet gjinore. Gjithashtu dhe vlera tjetër për partneritet dhe antarësime të reja, pra për programe të reja dhe shërbime eksperiencash. Projekti i katërt i cili Bashkia Roskovec sapo ka lidhur kontratën dhe jemi në zbatim është projekti “Climate Pathways 4 Roskovec”, pra rruga drejt përmirësimeve klimaterike për Bashkinë Roskovec dhe fondi i paraфинancimit pasi ne sapo kemi lidhur kontratën dhe akoma nuk jemi në zbatim të projektit, pjesa e parë 40%-shi i fondit vjen paraфинancim është në vlerën 5 milion e 818 lekë, e cila do të përdoret në kapitujt sipas tabelës së mëposhtme për shpenzimet operative dhe mirëmbajtjes. Elmazi- e kemi materialin, kush ka pyetje ler të bëjë..Kryetari- faleminderit, atëherë për pyetje në lidhje me këtë projekt-vendim? Nuk kemi asnjë kërkesë për pyetje, për diskutim në lidhje me këtë projekt-vendim? Po, fjala është për znj.Mira Buzi. Ermira- duke qënë se është rivitalizimi i qendrës komunitare Kurjan, jo se kam ndonjë gjë me mbështetjen e start-up-eve të reja, por do të doja përshembull që si projekt aty të ishte mbyllur dhe palestra, duke qënë se palestra është bërë vetëm nga jashtë rikonstrukcioni i parë dhe pjesa brenda lë shumë për të dëshiruar, atje parketi është shumë i rrënuar, ne nuk mund të punojmë dot atje me nxënësit dhe do të doja përshembull që thashë nuk kam asgjë me mbështetjen e start-up-eve të reja, po pse të mos ishte shënuar dhe bërja e parketit të palestres të shkollës tonë, faleminderit. Orgesa- projekti ka përfunduar, i ka pasur të specifikuara të gjitha punimet, objektivat dhe kush ishte thirrja dhe

objektivi i këtij projekti më tepër ka pasur të bëj me çertifikimin e të rinjve dhe ti japi atyre një zanat, sesa me rikonstruksionin e palestrës. Duke qënë se fondi pas financimit vjen pasi përfundon dhe çertifikohet i gjithë projekti, pastaj na vjen fondi, në momentin që ata i njohin të gjitha shpenzimet tona, ne keto fonde i kemi përdorur nga të ardhurat e Bashkisë Roskovec, nga zëri që kemi pasur për organizatat dhe për thirrje të tilla. Duke qënë se ky fond është përdorur nga Bashkia në ndihmë të këtij projekti dhe sot projekti i kthen këto lekë, do përdoren për të njëjtat direktiva ashtu siç i ka pasur edhe projekti. Nuk mund të bëjmë dot investime, nuk mund ti përdorim dot për rikonstruksion palestre dhe as për investime të tjera. Ermira- duke qënë se ajo ishte pjesë e projektit të Bashkimit European dhe ajo ngeli ngjysëm e pabërë, prandaj thashë që do ishte mirë që të bëhej dhe diçka atje. Orgesa- projekti është mbyllur dhe ne jemi çertifikuar dhe sipas tyre të gjitha standartet kanë qënë në rregull. Ermira- dhe meqënëse e mora fjalën, duhet ta kisha thënë qëparë mendimin tim dhe është shqetësim që e ngre vit për vit dhe në këtë pjesë kohore të mbledhjes së Këshillit. Të merren masat nga Bashkia që ato rikonstruksionet, ato punimet apo ndërhyrjet në shkolla të bëhen në kohën e duhur dhe të shikohen me kujdes dhe me vëmendje, sepse në tualete ka shumë nevoja për ndërhyrje, ka nevoja për suvatime të pjesshme, ka nevoja domethënë të venë specialistët të bëjnë evidentimin dhe në momentin që ne fillojmë shkollën, jo vetëm tek shkolla jonë por në të gjitha shkollat e Bashkisë të jenë gati. Ishte zëri më sipër tek pika që ishin disa shpenzime për shkollat, mos ti lini që ne të vemë në Shtator në punë dhe pastaj të fillojë. Jemi në Korrik, kemi Gushtin përpara, të merren masat, të punohet me intensitet, të mos ngelet thjesht në konstatim, duhet filluar thashë që nga ndriçimet, llambat, kanë shumë problematika shkollat. Të bëhet evidentimi një më një dhe pastaj të punohet që të rregullohen ato, dhe gjithsesi të merren masat dhe me lëndën djegëse se dimri..domethënë të bëhet planifikimi edhe për lëndën djegëse për në dimër. Kryetari- po, faleminderit Mira. Maksi- Mira mund të plotësojë, është ngritur grupi i punës, i kanë përcaktuar të gjitha ato difektet, ka bërë preventivat përkatës, ka kaluar në proces për blerje material dhe për mbyllje përpara Shtatorit. Leksi- një gjë nuk kuptova unë drejtoreshë, si çertifikohet objekti ose punimet, projekti si çertifikohet kur ai nuk ka mbaruar dhe nuk është funksional, përshembull objekti zbatimit ose palestra? Maksi- nuk ka qënë objekt i zbatimit..Leksi- ska qënë pjesë e projektit? Orgesa- jo, prandaj thashë unë objektivi i gjithë atij projekti që ne fituam ishte çertifikimi i të rinjve në kurse si berber, parukier, sekretar..Leksi- jo mirë në rregull, por diçka është investuar atje prandaj po them..Orgesa- ishte thjesht rikonstruksion i jashtëm i godinës. Kryetari- mirë faleminderit, do doja..Ermira- më fal, dakort janë ngritur grupet e punës, janë bërë konstatimet po kanë ngelur vetëm konstatime..Maksi- jo Mira, janë mbyllur procedurat..Ermira- po si janë mbyllur procedurat, këtu jemi ne dhe do flasim, tani ne e ngrejmë zërin në këtë pjesë kohe që të bëhen ato..Maksi- dakort, më duket se po debatoj kot me ty, sivjet ke pasur ndonjë problem me lëndën djegëse? Jo. Tani letrat, procedurat janë mbyllur dhe për këtë është ngritur grupi i punës, me Brikenën Drejtoreshën e Kulturës dhe të Shkollave, me Benin dhe me Aldin për të gjitha, për elektriket, për hidrauliket, për lyerje e të tëra me radhë, është ngritur grupi i punës, ka përcaktuar preventivin përkatës..Ermira- idea është që të fillohet nga puna..Maksi- po patjetër..Ermira- se duan kohë dhe ato, të gjitha gjërat që duhen bërë..Maksi- të lutem është mbyllur si procedurë..Ermira- edhe diçka tjetër meqënëse e ngrita dhe zërin këtu, edhe për murin rrethues të shkollës “Alush Grepcka” se po e bisedonim këtu, kemi 4 vjet që e ngrejmë këtë shqetësim..Kryetari- atëherë do ju lutesha që mos të dalim nga diskutimi i projekt-vendimit..Ermira- jo ishte pika më sipër dhe duhet ta kishim marr fjalën tek diskutimet..Kryetari- ju lutem kemi një pikë pas kësaj që janë diskutimet..Ermira- ishte pika më lart, duhet ti kishim

thënë atje..Kryetari- do tju lutem që diskutimet do i kemi në fund, që mos të dalim nga projekt-vendimi, do doja që..Elizabeta- jo do thoja që problematikat e shkollave duhen zgjidhur brenda verës, para se të filloj viti shkollor..Kryetari- unë jam shumë dakort dhe do ti trajtojmë sot këtu në këtë mbledhje, vetëm ti përmbahemi pak rendit të ditës sepse jemi me projekt-vendimin “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026”..Ermira- po ne rrallë e marrim fjalën o Kryetar, dhe tani që donim të flisnim ne ti nuk na le të flisnim..Kryetari- do të doja që edhe në emrin tuaj të falenderoj atë pjesë të shëndetshme të administratës së Bashkisë Roskovec, e cila gjenë kurajon bën projekte kaq të mira sa që ne sot këtu diskutojmë për fondet, të cilat nuk vijnë drejtpërdrejtë nga taskapaguesit e Bashkisë tonë por janë fonde të përfituara nga burime të tjera, përtej mundësive finaciare që ka Bashkia Roskovec. E ndoqa me vëmendje diskutimin e znj.Mira dhe patjetër do doja që shqetësimin që ajo ngriti përsa i takon cilësisë së dyshemesë në palestrën e shkollës “Didin Bishani” të merren në konsideratë në kuadrin e rikonstruksionit dhe përgatitjes së shkollave..Në sallë ka diskutim midis Zhakut dhe Maksit. Zhaku- shikoj vet Maksi dhe bëj..Kryetari- po patjetër pra..Zhaku- jo patjetër se janë gjëra të domosdoshme, pse e kalon ashtu? Kryetari- unë nuk po e kalojë ashtu..Zhaku- mos e kalo o burrë, thuaj që do bëhen..Maksi- do bëhen të thashë edhe njëherë..Zhaku- po jo ore Maksi pse tani, ti duhet ta shikosh vet këtë punë, shikojë vet edhe zgjidhe..Në sallë ka diskutime. Fredi- nuk është pikë e rendit të ditës por meqë u hap ky diskutim për problemin e arsimit, pavarësisht se unë nuk jam i fushës por kur kam vajtur atje jam skandalizuar. Ja tek jemi këtu këshilltar, pa filluar shkolla, pa filluar viti shkollor ne këshilltarët do kontrollojmë shkollë më shkollë, jemi dakort këshilltar? Këshilltarët shprehen po. Në sallë ka diskutime. Kryetari- absolutisht more, por ky diskutim që ne po bëjmë..Zhaku- unë jam i gatshëm, nëse ska fond kontribojmë ne..Kryetari- ju lutem që të respektojmë rendin e ditës, po ju propozoj që të mbarojmë diskutimin me projekt-vendimin që kemi..Zhaku- po mos kalo kështu se nuk është një gjë e parëndësishme, është shumë e rëndësishme..Kryetari- absolutisht, unë prandaj po mundohem që në përfundim të votimit ti japim rëndësinë e duhur dhe të merremi çik më gjatë me atë problematikë..Zhaku- në qoftë se nuk ka fond unë jam i gatshëm personalisht..Kryetari- po absolutisht pra tani, po të lutem duhet ta kuptosh..Orgesa- sapo e miratove, ishte tek pika e mësipërme që ju të gjithë e miratuat, e ke aty fondin..Në sallë vazhdojnë akoma diskutimet. Maksi- për këtë pikë informoj këshilltarët që 2 shkolla 4 vjeçare apo të fillores, një në Jagodinë dhe një në Arapaj ka filluar rikonstruksioni për të mbyllur, komplet rikonstruksion, 8 apo 9 shkolla ne i kemi të rikonstruktura në gjithë Bashkinë e Roskovecit..Fredi- ore ne themi për gjëra bazike, lëri llaflologjirat, lëre fasadën. Unë po them do vemi ta kontrollojmë, ore banjot është problem, Mira e tha, i bie i ka ardhur zor të prishi performancën, unë jam skandalizuar atje..Maksi- po kush të tha jo ty..Fredi- e kupton një grup këshilltarësh, unë vet do vete, kush të dojë ler të vij, do vete shkollë më shkollë, është turp ore, banjot janë më problematike dhe uji..Zhaku- është gjëja më minimale. Kryetari- atëherë ju ftoj të gjithëve që të më jepni vetëm pak kohë të përfundojë diskutimin dhe votimin për projekt-vendimin që jemi duke diskutuar dhe të gjithë këtë problematikë që edhe unë e quaj të rëndësishme sa ju, mendova ti jepnim rëndësinë e veçantë dhe ta diskutojmë ashtu siç duhet. Ermira- atë murin do e bëjmë ne tek “Alush Grepcka”? Leksi- po dale të vemë tek pika e fundit o Mira..Kryetari- po znj.Elizabeta e ka fjalën, në lidhje me këtë projekt-vendim? Elizabeta- në lidhje me rrethimin e shkollës “Alush Grepcka”, unë nuk dua që të ngelet në hije, e kam ngritur si shqetësim..Kryetari- znj.Elizabeta ju lutem tregohuni pak më mirkuptuese, jemi duke diskutuar projekt-vendimin për miratim fondesh shtesë dhe po ju them që të mbarojmë procedurën dhe në pikën e fundit që ne

kemi diskutime, të gjithë problematikat që ju keni ti rendisni edhe njëherë dhe publikisht të kërkojmë zgjidhjen e tyre, nuk kemi anashkaluar asnjë gjë. Në lidhje me këtë projekt-vendim kërkon dikush fjalën për diskutim? Nuk ka. Kryetari- ju ftoj atëherë të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2026”. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materialit të paraqitur dhe miratohet me 12 vota pro, 2 vota abstenim F.Feleqi, A.Pelo. Kryetari- me 12 vota pro, 2 vota abstenim miratohet ky projekt-vendim, faleminderit për votimin.

12.Diskutime dhe komente të qytetarëve.


Kryetari- tani do ju lutesha që të gjitha këto probleme që dolën këtu dhe për shkak të faktit që një pjesë e mirë e këshilltarëve i përkasin sferës së arsimit dhe janë më të ndjeshëm ndaj problematikave të tyre, do doja që edhe njëherë në mënyrë kronologjike le ti fiksojmë dhe në procesverbalin e mbledhjes, faleminderit për mirkuptimin. Mira? Ermira- po tani na iku dhe frymëzimi çka të themi..Kryetari- atëherë znj.Elizabeta, pastaj z.Fredi..Elizabeta- në lidhje me murin rrethues të shkollës “Alush Grepcka”, ka nevojë për ndërhyrje pasi muri është i ulët dhe duhet që lartësia të rritet me kangjella. Kjo është bërë ankesë e herë pas hershme dhe duhet të reflektohet në mënyrë të mënjëhershme, pasi kjo gjë rrezikon edhe jetën e fëmijëve, gjithashtu dhe manuali i riskut del në një risk më të lartë për këtë arsye. Gjithashtu të rishikohen kasetat, shkarkimet e ujit dhe çdo gjë që është për tu rikonstruktuar, pasi janë material jo në cilësinë e duhur dhe janë të konsumuara, si dhe cilësia e detergjentëve që vjen nëpër shkolla të jetë e një cilësie më të mirë, edhe sasia të shtohet pasi ambientet janë të shumta dhe numri i nxënësve është më i lartë se në shkollat e tjera të ZVA-së, dhe duhet që sasia e detergjentëve të jetë më e madhe. Gjithashtu të merren masa dhe për lëndën djegëse siç e tha edhe kolegja ime parafolëse, pasi vjen me vonesë dhe dimri fillon më herët dhe sasia e karburantit që vjen, vjen me vonë dhe duhet të jetë më e lartë. Kryetari- faleminderit znj.Elizabeta. Ermira- të filloj puna që tani, domethënë me pastrimin e..e mora vet fjalën, të pastrohen oborret rreth e rrotull shkollës njëherë që tani, se bëhen ca gjëmbaç e ca ferra anës shkollës që edhe kur pastrohen ato pastaj, venë fëmijët edhe çpohen me ato gjëmbat. Të gjitha oborret dhe ambientet e shkollave të jenë të pastruara, të jenë të pastruara nga mbetjet plastike edhe rrugët që të çojnë në institucionet e shkollave, dhe koshat e mbeturinave që janë atje rreth e rrotull. Pastaj brenda problematikat dihen, janë tualetet, janë problematikat e suvave të pjesshme apo të dhyerëve dhe dritareve të cilat institucionet nuk i kanë të sakta dhe të rregulluara, janë problemet e ndriçimit, janë problemet e shkarkimit dhe palestra që e thashë dhe qëparë, ajo është jashtë funksionit sot për sot..Kryetari- dhe të merren masa përpara fillimit të vitit të ri shkollor. Atëherë fjalën e kishte kërkuar z.Fredi dhe z.Zhaku pastaj. Fredi- unë kam një propozim, mbase do duket kështu po meqë është 24 Korriku dhe për mua është dita e festës së Kryetares sepse sështë asnjë gjë tjetër, nuk parashikon asnjë gjë tjetër por unë kam një propozim tjetër dhe dua të më mbështesin këshilltarët. Atje në hyrje të Roskovecit tek rrethrrrotullimi është vendosur një bukuroshja e Strumit, nuk e di gojëdhëna e budallëqe kot aty..Leksi- vajza myzeqare..Fred- një sekondë të lutem, unë kam një propozim, që të hiqet ajo statuja atje sepse ajo është ngjysëm nudo, të hiqet dhe të vendoset nga drejtorja e saj, ne as zakon e kemi, as traditë e kemi pasur, as atëherë e as tani. Ajo është një prezantim për mua është shumë i keq sinqerisht, mbase dukem patriakal por të propozohet një statujë, miratojmë një fond tjetër sepse sinqerisht mua më duket e tepërt. Nuk e kemi as traditë, as zakon, edhe ajo bukuroshja e Strumit gojëdhëna unë kam pyetur nuk është asnjë

gjë, e kupton? Edhe unë kam pyetur, nuk është asnjë gjë në histori por të paktën atje mos të prezantohemi në hyrje të qytetit me atë ngjysëm nudo. Unë e kam propozim, kërkojë mbështetjen e këshilltarëve, si të duan të bëjnë. Zhaku- ta heqim apo ta mbulojmë? Fredi- ta heqim ose ta mbulojmë të paktën, sinqerisht po ta them..Maksi- i ke skulpturat nëpër muzetë e botës..Fredi- janë në muze nuk janë në hyrje të Roskovecit, janë në kënde lojrash edhe unë kam qënë jashtë, janë në kënde, janë në parqë, të lutem Maksi dëgjo një sekondë, nuk e kam për lojë, nuk e kam as për kundrapeshë, e kam sinqerisht. Zhaku- o Fredi edhe po të hiqet ajo nuk harrohet, ajo është në çdo video..Fredi- ça të them unë, merreni qesharake siç e morët termocentralin, siç e morët atëherë turp i zotit, merreni dhe këtë dhe unë se kam as për kundra as për gjë, e kam seriozisht. Po deshët bëjeni, të marrim një vendim ta heqim se nuk është vepër arti atje lakuriq, vendoset nëpër parqe..Maksi- o Fredi do vendoset dhe një tjetër midis Strumit dhe Sukut..Fredi- për mua vendose, unë në familjen time vendos çka të më dojë qejfi, ti vendose në familjen tënde po jo këtu se të paktën e kupton, vendose atje ku jeton ti se je jashtë zonës, të lutem Maksi nuk jeton këtu..Kryetari- faleminderit z.Fredi, z.Zhaku dhe pastaj të përgatitet Leksi. Zhaku- unë do ngrija një shqetësim, para se të vendosen emrat e rrugës do doja që rruga Marinëz-Suk të pastrohen barishtet anës rrugës, të mbushen gropat pasi dëmtojnë makinat që kalojnë, edhe barishtet që janë anës rrugës pengojnë fushëpamjen, janë burim aksidenti. Shpresoj që ta bëni pa vendosur emrat që të jetë diçka e pastër. Maksi- për pastrimin se rruga nuk është e jona që të jemi korrekt..Zhaku- ta pastrosh..Maksi- pastrim po jemi dakort..Zhaku- dhe të mbushësh gropat, jo ta bësh rrugë të re..Maksi- po patjetër, ti e di që ne kemi bërë shtesa atje..Zhaku- ato shtesat ti mbushësh..Maksi- ok..Zhaku- në rregull do bëhen apo jo? Të bëhen pa vendosur emrat..Maksi- po dakort, pastrimi i rrugës do bëhet urgjentisht..Kryetari- z.Zhaku dhe për shkollat kishe gjë që mos ta marrësh prapë fjalën? Zhaku- për shkollat ne në Shtator do jemi në çdo shkollë, do shikojmë çfarë mungese ka. Na jepni fjalën që ju do i bëni ato që thatë, që të mos ketë mungesë të ujit të pijshëm nëpër shkolla ose uji nëpër tualete se është turp të diskutojmë këto gjëra, dhe në shkollën Agaçaj si koshi i plehrave që është atje tek kopshti atje, te shkolla 4 vjeçare të pastrohet dhe të vendoset kosh i ri. Kryetari- faleminderit, fjala është për z.Leksi. Leksi- është e disajta herë që e ngre shqetësimin e banorëve të qytetit të Roskovecit, të cilët janë prezent, e shikojnë dhe e ndiejnë aromën e keqe që përhap kanali i ujrave të zeza që kalon përpara shtëpive të tyre, që është pjesë e investimit për Unazën. Meqënëse kjo është ndarë më vete dhe kaloj tani asfaltim, do të thotë që kërkohet patjetër një investim tjetër, që ky kanal të mbyllet për arsye sepse jo vetëm ata familjarët që janë aty por të gjithë familjarët këtej në qytetin e Roskovecit, nuk munden ta durojnë atë erë. Sa për pjesën e shkollave, me të vërtetë punimet ler të fillojnë dhe mbështes këshilltarët, koleget e mia dhe kolegu Fredi dhe Zhaku, që të jemi dhe ne prezent në..se prezent në punime nuk do jemi por të paktën të shikojmë që a janë realizuar a sjanë realizuar ato që janë premtuar. Ndërsa përsa i përketë asaj që tha dhe kolegu Fredi për pjesën e asaj vajzës myzeqare, edhe unë kam qënë skeptik por ai është një investim prej 10 vitesh..Kryetari- nuk e kishim për debat, se kush këtu nga ne ka mendimin e vet dhe nuk ka nevojë fare..Leksi- jo mo jo edhe unë kam qënë skeptik, po 10 vjet tani ça ti kthehem, meqënëse i bëri pyetje këshilltarëve për këtë po them..Kryetari- ju lutem secili ka mendimin e vet, nëse e mbaruat diskutimin tuaj faleminderit..Leksi- unë mbarova se më ndërhytë direkt edhe ata andej, edhe këtu, për çka më ndërhytë se mora vesh..Kryetari- po sepse ju po merreni me diskutimin e dikujt tjetër, nuk jemi këtu për të bindur njëri-tjetrin..Leksi- jo sthashë, bëri një propozim si antar Këshilli që të vemi atje nëpër shkolla, unë thashë domethënë e mbështes, edhe shqetësimet të paktën mos të ngelen në kuadër të letrave, të realizohen. Kryetari- nuk jemi për të vlerësuar njëri-

tjetrin, secili ka mendimin e vet..Leksi-po pra..Kryetari- atëherë dikush tjetër e kërkonte fjalën për diskutim? Në lidhje me atë çështjen e shkollave besoj që mori një forëm çik më zyrtare e gjitha. Kemi harruar diçka? Atëherë nga ana e administratës pranë sekretarisë është paraqitur një informacion në lidhje me kërkesat e ngritura në këtë Këshill, në mbledhjen e herës së kaluar. Është pak voluminoz se tregon gjithë rrugën sesi ka ardhur përgjigja, por neve na intereson dhe besoj shkurtimisht përgjigja..Elmazi- me leje Kryetar, informacionet të cilat vijnë duhet të jetë vet punonjësi që i jep dhe ti argumentojë kush është bërë dhe kush nuk është bërë, se në qoftë se do i japësh ti ato dhe ata sjanë këtu, kush do përgjigjet? Kryetari- jo këto janë përgjigje zyrtare që unë i ftoj këshilltarët të vijnë ti marrin në përfundim të mbledhjes..Maksi- secili këshilltar ka pyetjen e vet të marri përgjigje, dhe në qoftë se ka pyetje..Leksi- unë një mendim kam o Kryetar, tani a vijnë çik më të thjeshta këto sepse në bazë të ligjit kaq e kaq fillojnë ata dhe si e si në fund fare nuk e japin atë përgjigjen e duhur, të vijnë çik më të thjeshta..Kryetari- në nisje të fjalës time thashë që materiali është voluminoz dhe tregon gjithë rrugën sesi ka ardhur përgjigja, ndërkohë që ne na interesonte vetëm përgjigja..Leksi- vetëm finale..Kryetari- dhe një argumentim të thjeshtë siç tha z.Elmaz, kështu që këtë e kam kërkesë për administratën, që nuk ka nevojë që ne të dimë gjithë procedurën..Fredri- janë llafollogjira absolutisht, janë justifikime kot..Kryetari- të njëjtën gjë po themi po mbase kur e thoni ju merr më shumë vlerë..Fredri- ne duam sqarime të thjeshta fare..Kryetari- fiks, është e qartë. Atëherë për të gjithë këshilltarët që kanë pasur një kërkesë, janë të ftuar që të marrin personalisht një kopje të përgjigjeve të dhëna nga ana e administratës. Duke ju falenderuar edhe njëherë për pjesmarrjen, e deklarojë këtë mbledhje të mbyllur.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

